



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT  
TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga Prefekti Qendror  
Eideh dhe mban nga dërguesi nr. \_\_\_\_\_ prot  
datë 13.12.2022 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda) Për vendimin 1255/1  
e K. Bashkisë nr. 115 datë 27.10.2022

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 5688/1  
16.12.2022 datë \_\_\_\_\_

Praktika u drejtohet për administrim:

-Znj/Z \_\_\_\_\_

Drejtorisë

Ekonomike ✓

-Znj/Z \_\_\_\_\_

-Znj/Z \_\_\_\_\_

Sektorit të pronave dhe Stokut

-Znj/Z \_\_\_\_\_

me porosinë: \_\_\_\_\_


Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ...etj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar do të jetë \_\_\_\_\_

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore: \_\_\_\_\_

Peshkopi, më \_\_\_\_\_ .202\_\_

NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.1255/1.prot.

Peshkopi, më 13.12.2022

Lënda : Per vendimin nr. 115, datë 06.12.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.115, date 06.12.2022 “Për miratimin e pagesës së qerasë për Zyra në subjektin politik Vendor “PD“, konstatova se:


Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje , veprim që kurdoherë është përgjegjësi direkte administrativo-ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër .

Aktet administrative të karakterit individual , hyjnë në fuqi menjëherë sipas përcaktimit të nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 5698 Prot

Peshkopi, më 12.12.2022

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.115**

**Datë:** 06.12.2022

**“Për miratimin e pagesës së qerasë për zyra për Subjektin Politik Vendor (PD)”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**

**Afrim Mikli**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 115, date, 06/12/2022

**“ Për miratimin e pagesës së qerasë për zyra për Subjektin Politik Vendor (PD)”**

Mbështetur ne ligjin nr. 139/2015 “ Per vetëqeverisjen vendore” në zbatim të ligjit nr. 8580 date 17.02.2000 “ Për partitë politike” i ndryshuar, në referim të nenit 22/b ku citohet se partitë parlamentare pajisen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore. Kur kjo eshte e pamundur shteti merr persiper pagesen e qerases. Këtë të drejtë e ka edhe partia politike, mesatarja e votave të së cilës në tri zgjedhjet e fundit parlamentare ka qenë mbi 1 për qind në shkallë vendi.” Ne zbatim te ligjit nr. 10374, date 10.02.2011 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8580, date 17.02.2000 “ Per partite politike”, te ndryshuar, referuar nenit 22/1 citohet se:

1. Kërkesa për pajisje me ndërtesë, sipas shkronjës "b" të nenit 22, i paraqitet Ministrit të Brendshëm, për pronat shtetërore, në administrim të pushtetit qendror, dhe kryetarit të bashkisë, për pronat që janë pronësi ose në përdorim të pushtetit vendor, të cilët marrin të gjitha masat e nevojshme për pajisjen e partisë parlamentare me ndërtesë.
2. Kur gjenden ndërtesa të lira, sipas rastit, Ministri i Brendshëm ose kryetari i bashkisë lidh kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me partinë politike që ka të drejtën e ndërtesës, sipas shkronjës "b" të nenit 22. Kur nuk gjenden ndërtesa të lira, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike. Kontrata e huapërdorjes ose pagimi i qirasë, sipas këtij neni, për partitë politike zgjat për aq kohë sa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në shkronjën "b" të nenit 22.

Referuar Invetarit te Pronave te Paluajtshme te Bashkise Diber te miratuar me VKM nr.1533, date 19.11.2008 “ Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi apo ne perdorim te Bashkise Peshkopi, te Qarkut Diber, nuk disponojme objekt te lire qe mund te vihet ne dispozicion te Subjektit Politik Vendor ( PD)

Nga sa më sipër ne zbatim te nenit 22/1 pika 3 te ligjit nr. 10374, date 10.02.2011 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8580, date 17.02.2000 “ Per partite politike”, te ndryshuar, per paisjen me ndertese Subjektin Politik Partia Demokratike Dega Diber, me propozim te Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **06.12.2022** me 19 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë pagesen deri ne 40000 lek/muaj ( dyzet mije) per qerane e nderteses per zyra per Subjektin Politik Partia Demokratike Dega Diber.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë do te jete deri ne 1 vit nga momenti i hyrjes ne fuqi i vendimit.
3. Pagesa e qerase do te filloje pasi Subjekti Politik (PD) te paraqese kontraten e qerase noteriale dhe pagesa do të bëhet në numrin e llogarise të pronarit të objektit.
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomike, Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit.
- 5 . Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit i Prefektit të Qarkut, Diber.
6. Vendimi u shpall me date **06.12.2022**.

**Kryetar Këshilli**

**Sokol Sava**





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA DIBER  
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TE PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT VENDIM  
Nr. 05, date, 30 / 11 / 2022

**“ PER MIRATIMIN E PAGESES SE QERASE PER ZYRA PER SUBJEKTIN POLITIK  
VENDOR ( PD ) ”**

Mbështetur ne ligjin nr. 139/2015 “ Per vetëqeverisjen vendore” ne zbatim te ligjit nr. 8580 date 17.02.2000 “ Per partite politike” I ndryshuar, ne referim te nenit 22/b ku citohet se partitë parlamentare pajisen me ndërtesë për selinë e tyre qendrore dhe zyra vendore. Kur kjo eshte e pamundur shteti merr persiper pagesen e qerases. Këtë të drejtë e ka edhe partia politike, mesatarja e votave të së cilës në tri zgjedhjet e fundit parlamentare ka qenë mbi 1 për qind në shkallë vendi.” Ne zbatim te ligjit nr. 10374, date 10.02.2011 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8580, date 17.02.2000 “ Per partite politike”, te ndryshuar, referuar nenit 22/1 citohet se:

1. Kërkesa për pajisje me ndërtesë, sipas shkronjës "b" të nenit 22, i paraqitet Ministrit të Brendshëm, për pronat shtetërore, në administrim të pushtetit qendror, dhe kryetarit të bashkisë, për pronat që janë pronësi ose në përdorim të pushtetit vendor, të cilët marrin të gjitha masat e nevojshme për pajisjen e partisë parlamentare me ndërtesë.
2. Kur gjenden ndërtesa të lira, sipas rastit, Ministri i Brendshëm ose kryetari i bashkisë lidh kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me partinë politike që ka të drejtën e ndërtesës, sipas shkronjës "b" të nenit 22. Kur nuk gjenden ndërtesa të lira, shteti merr përsipër pagesën e qirasë së selisë qendrore dhe të zyrave vendore të partisë politike. Kontrata e huapërdorjes ose pagimi i qirasë, sipas këtij neni, për partitë politike zgjat për aq kohë sa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në shkronjën "b" të nenit 22.

Referuar Inventarit te Pronave te Paluajtshme te Bashkise Dibër te miratuar me VKM nr.1533, date 19.11.2008 “ Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajtshme publike, shteterore, qe transferohen ne pronesi apo ne perdorim te Bashkise Peshkopi, te Qarkut Dibër, nuk disponojme objekt te lire qe mund te vihet ne dispozicion te Subjektit Politik Vendore ( PD)

Nga sa më sipër ne zbatim te nenit 22/1 pika 3 te ligjit nr. 10374, date 10.02.2011 “ Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 8580, date 17.02.2000 “ Per partite politike”, te ndryshuar, per paisjen me ndertese Subjektin Politik Partia Demokratike Dega Dibër, me propozim te Kryetarit të Bashkisë ne mbledhjen e këshillit bashkiak te dates \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**PROPOZON :**



1. Të miratojë pagesen deri ne 40000 lek/muaj ( dyzet mije) per qerane e ndertesës per zyra per Subjektin Politik Partia Demokratike Dega Diber.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë do te jete deri ne 1 vit nga momenti i hyrjes ne fuqi i vendimit.
3. Pagesa e qerase do te filloje pasi Subjekti Politik (PD) te paraqese kontraten e qerase noteriale
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomike, Sektori i Administrimit te Pronave dhe Strehimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Diber.

P/Sektorit te Adm. Te  
Pronave dhe Strehimit  
Gazmend Miftari

Drejtori Ekonomik  
Mensur Shehi

P/Sektorit Juridik  
Elona Lusha

**KRYETARI I BASHKISË**

**Rafik SPAHIU**

